



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 6861 prot.

Elbasan, më 7.7.2025

Lënda: Konfirmim akti.

KËSHILLIT BASHKIAK LIBRAZHD

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr. 107/2016 datë 27.10.2016 “ Për Prefektin e Qarkut ”, u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.54 datë 24.06.2025 ” Për miratimin e marrëveshjes midis Entit Kombëtar të Banesave dhe Bashkisë Librazhd dhe dhurimin e pasurisë nr.1/709, ZK.2446 me sip.900m² në favor të Entit Kombëtar të Banesave ” konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.



PREFEKTI

Ilir BEJTJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 696

81. 27.6.2025



VENDIM

Datë.26.06.2025

Nr.4458 prot

Nr.54 dt.24.06.2025

**PËR MIRATIMIN E MARRVESHJES MIDIS ENTIT KOMBËTAR TË BANESAVE
DHE BASHKISË LIBRAZHD DHE DHURIMIN E PASURISË NR.1/709,ZK 2446 ME
SIPËRFAQE 900 M2,NË FAVOR TË ENTIT KOMBËTAR TË BANESVE”**

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar neni 54, Ligji nr 7850 datë 29.07.1994 “ Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar ,Ligji nr.7980 datë 27.07.1995 “Për shitblerjen e pronave”,Ligji nr 8743 datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” si dhe VKM-në nr.1086 datë 28.10.2009 “ Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Librazhd,të Qarkut Elbasan” Vendimit nr.17,date 29.05.2025 të Entit Kombëtar të Banesave,shkresën nr.1843/1 prot,date 09.06.2025 të Entit Kombëtar të Banesave bazuar në kopetancat që na jep ligji,Keshilli Bashkiak I mbledhur sot me date 24.06.2025 dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd.

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit mbi zbatimin e programit për ndërtimin e banesave me kosto të ulët në Bashkinë Librazhd midis Entit Kombëtar të Banesave dhe Bashkisë Librazhd.
2. Miratimin e dhurimit të pasurisë Nr.1/709, lloji I pasurisë truall,me sipërfaqe 900m2 në pronësi të Bashkisë Librazhd në favor të Entit Kombëtar të Banesave;
3. Pasuria Nr.1/709,lloji I pasurisë truall, me sipërfaqe 900m2 në pronësi të Bashkisë Librazhd,i dhurohet Entit Kombëtar të Banesave me qëllim që EKB të ndërtoj një objekt banimi me 6 kate dhe me një kat parikimi nëntokë;
4. Objekti I banimit klasifikohet në programin e banesave me kosto të ulët dhe do të shërbejë për strehimin e familjeve që kanë aplikuar pranë Bashkisë Librazhd për të përfutur banesë me kosto të ulët;
5. Bashkia Librazhd merr përsipër të gjitha angazhimet sipas marrveshjes me Entin Kombëtar të Banesave;
6. Autorizohet Kryetari I Bashkisë Librazhd të kryej procedurat për kalimin e pronësisë,të nënshkruaj kontratën e dhurimit para noterit;
7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari I Bashkisë Librazhd,Sekretari I Përgjithshëm,Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillim të Territorit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar.
8. Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes.

SEKRETAR I KËSHILLIT
Elson MALLUTA

KRYETARI I KËSHILLIT
Mitat BICAKU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI KOMBËTAR I BANESAVE

Nr. 1843_h prot, datë 26/06/2025

(Selia: Rruga e Kavajës, ndërtesa Nr.80, hyrja 1,
kati 5 (ish shtëpia botuese "Naim Frashëri" Tiranë)

BASHKIA LIBRAZHD

Nr. 446 prot, datë 26/06/2025

(Selia:)

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

MBI ZBATIMIN E PROGRAMIT PËR NDËRTIMIN E BANESAVE ME KOSTO TË ULËT NË BASHKINË LIBRAZHD

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjin nr.22/2018 "Për Strehimin Social" i ndryshuar, si dhe në përputhje me Vendimin Nr.198 datë 4.05.1993 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Entit Kombëtar të Banesave" i ndryshuar:

Lidhet kjo marrëveshje bashkëpunimi, ndërmjet palëve:

- **Enti Kombëtar i Banesave**, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, Z. Besmir Hysa;
dhe
- **Bashkia e qytetit Librazhd**, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë, Z.Mariglen Disha.

Neni 1

Qëllimi i marrëveshjes

1. Qëllimi i marrëveshjes është të përcaktojë angazhimin e ndërsjellë të Entit Kombëtar të Banesave dhe të Bashkisë Librazhd, për një bashkëpunim dypalësh në funksion të përcaktimit të fushave, masave dhe mënyrave të bashkëpunimit, si dhe të sigurimit të mbështetjes së nevojshme institucionale nëpërmjet zbatimit të legjislacionit të fuqi me pikësynimin:

- a) për të kontribuar në përmbushjen e objektivave të Qeverisë për politikat sociale të strehimit, si një nga prioritetet e saj;
- b) për të adresuar problemet e strehimit për shtresat të cilat nuk mund të përballojnë dot çmimet e banesave në tregun e shtërive.

Adresa: Rr. e Kavajës, ndërtesa nr.80, hyrja 1, kati 5, (ish shtëpia botuese Naim Frashëri) Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 42 22 11 96 email: info@ekb.gov.al; www.ekb.gov.al

- c) për të realizuar ndërtimin e një banese me kosto të ulët dhe efikasitet energjie;
- d) për të miratuar në parim, vazhdimin e bashkëpunimit në fushën e strehimit, duke eksploruar bashkërisht forma të tjera ligjore.

Neni 2

Objekti dhe Kushtet e marrëveshjes

1. Objekt i akt-marrëveshjes është financimi dhe ndërtimi gjatë viteve 2025-2029 i një objekti banimi me 6 kate dhe me një kat parkimi nëntokë.
2. Financimi i objektit do të realizohet nga të ardhurat e vetë Entit Kombëtar të Banesave.
3. Objekti i banimit klasifikohet në programin e banesave me kosto të ulët dhe do të shërbejë për strehimin e familjeve që kanë aplikuar pranë Bashkisë Librazhd, për të përfituar banesë me kosto të ulët.

Neni 3

Angazhimet, detyrimet dhe përgjegjësitë e palëve

1. Palët e kësaj marrëveshje angazhohen:

- Të bashkëpunojnë me vullnet të lirë dhe në mënyrë konstruktive në drejtim përmbushjes së qëllimit të kësaj marrëveshje, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi;
- Në çdo rast, kur është e mundur, të publikojnë vlerat dhe kontributet e njëra-tjetrës në këtë projekt të përbashkët.

2. Enti Kombëtar i Banesave, si palë e kësaj marrëveshje, merr përsipër:

- a) të realizojë financimin e plotë të një banese ku përfshihen: projektimi, ndërtimi, mbikqyrja, kolaudimi dhe regjistrimi i pasurisë në emër të Entit Kombëtar të Banesave;
- b) të vendosë në dispozicion të Bashkisë Librazhd të dhënat teknike-ekonomike të banesës (strukturat, sipërfaqet, çmimet e apartamenteve, etj), si dhe kriteret e tjera paraprake që konsiderohen të domosdoshme nga EKB (psh. minimumin e të ardhurave që duhet të ketë familja përfituese etj.), në funksion të përzgjedhjes, hartimit dhe miratimit të listave të familjeve përfituese nëpërmjet Këshillit Bashkiak.

3. Bashkia Librazhd, si palë e kësaj marrëveshje merr përsipër:

- a) Të vërë në dispozicion të projektit:

- truallin ku do të ndërtohet objekti i banimit me sipërfaqje 900 m², të ndodhur në Zonën kadastrale 2446, me nr.pasurie 1/709, në Librazhd, të lirë fizikisht dhe juridikisht/ligjorisht, nëpërmjet kontratës së dhurimit për dhurimin e truallit në favor të EKB-së.
- dokumentacionin tekniko-ligjor (çertifikatën për vërtetim pronësie të lirë nga çdo kufizim, barrë hipotekore, etj..) që disponohet për truallin ku do të ndërtohet;

b) të vërë në dispozicion të EKB-së lejen përkatëse të zhvillimit dhe ndërtimit për objektin e banimit, brenda afatit ligjor nga momenti i aplikimit online nga EKB për këtë objekt, të pajisur me studim;

c) të eliminojë pagesën e taksës mbi infrastrukturën me Vendim nga Këshilli Bashkiak;

d) të investojë për sistemimin dhe infrastrukturën e zonës, duke përfshirë edhe rrjetin inxhinierik;

e) të sigurojë brenda një afati 2 (dy) muajor nga data e njoftimit/kërkesës nga Enti Kombëtar i Banesave (*referuar nenit 73, pika 2/a të Ligjit Nr.22/2018 i ndryshuar*), sipas kriterëve të negociuara mes palëve, listën e familjeve përfituese të këtij programi, të miratuar nga Këshilli Bashkiak Librazhd ku të jenë specifikuar për çdo familje: pallati, kati, numri i apartamentit, struktura, sipërfaqja respektive dhe statusi i familjes nëse ka në përbërje persona PAK.

f) të garantojë EKB-në se do të përgjigjet për çdo detyrim ndaj palëve të treta të cilat kanë dhe/ose mund të ngrenë pretendime për truallin që vendoset në dispozicion për realizimin e këtij investimi.

4. Palët bien dakord që:

a) Ndarja e apartamenteve të banimit, për familjet që do të përfitojnë strehim nga ky investim, do të bëhet me vendim të Këshillit Bashkiak Librazhd, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara nga Enti Kombëtar i Banesave, konform legjislacionit në fuqi.

b) Mënyra e shitjes së apartamenteve do të realizohet duke zbatuar një nga mënyrat e miratuara me Vendimin e Këshillit Drejtues të Entit Kombëtar të Banesave, mbështetur në legjislacionin në fuqi.

Neni 4

Vlefshmëria dhe zbatimi i marrëveshjes

Kjo marrëveshje është e vlefshme për një periudhë 4 (katër) vjeçare nga momenti i nënshkrimit të saj nga palët. Vlefshmëria e marrëveshjes mund të zgjatet me mirëkuptimin dhe vullnetin e palëve, kur këta të fundit nuk i kanë përmbushur detyrimet e tyre në kohë. Marrëveshja mund të rishikohet dhe të ndryshojë vetëm me shkrim dhe me nënshkrimin e të dy palëve.

Palët duhet të bëjnë çdo përpjekje për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes tyre me negociata direkte dhe me mirëkuptim. Në rast të kundërt, mosmarrëveshjet do të zgjidhen sipas procedurave juridike ligjore në fuqi, bazuar në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 5

Bashkërendimi i marrëveshjes

Palët bien dakord të përcaktojnë një/disë përfaqësues si pikë kontakti për secilën palë me qëllim bashkërendimin e punës në praktikë. Këta përfaqësues do të kenë kontakte direkte me institucionet respektive.

Pikat e kontaktit duhet të mbajnë të informuar në çdo kohë titullarin e palës përkatëse mbi ecurinë e zbatimit të marrëveshjes.

Neni 6
Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe:

- dy kopje për Drejtorinë e Përgjithshme të Entit Kombëtar të Banesave;
- dy kopje për Bashkinë e qytetit Librazhd.

Kjo marrëveshje hyn në fuqi pasi të jetë miratuar paraprakisht me vendimarrje nga Këshilli Drejtues i EKB-së dhe nga Këshilli Bashkiak i Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore, si dhe më pas me nënshkrimin e saj nga palët përkatëse (Drejtori i Përgjithshëm i EKB-së dhe Kryetari i Bashkisë).

PËR
ENTIN KOMBËTAR TË BANESAVE

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Besmir Hysa



PËR
BASHKINË LIBRAZHD

KRYETAR

Martiglen Disha

